

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka- kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Valon Totaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.B. nga fshati ..., Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. M.B. nga Rahoveci, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, devizioni i furnizimit, Distrikti në Gjakovë, të cilën me autorizim e përfaqëson B.A., me objekt të padisë kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Rahovec C.nr.155/12, të datës 21.11.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës- Distrikti në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Rahovec C.nr.155/12, i datës 21.11.2013, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.155/12, të datës 21.11.2013, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit V.B. dhe e ka obliguar të paditurën Korporata Energjetike e Kosovës- Distrikti në Gjakovë, që paditësit t'ia paguajë shumën prej 12,074,00 euro, në emër të pagave të pa paguara për punët dhe detyrat e punës si kordinator i ND në Rahovec, për periudhën prej 10.09.2010, e deri me 17.09.2012, ku është përfshirë edhe kamatë ligjore, si dhe shumën prej 778,36 euro, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes qenësore të dispozitave procedurale kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar pala paditëse përmes të autorizuarit të saj, përmes së cilës ka kërkuar që të refuzohet ankesa e palës së paditur si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është **e pa themeltë**.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi V.B. përmes të autorizuarit të tij, me datën 07.08.2012, ka dorëzuar në gjykatën e shkallës së parë padi ndaj të paditurës

Korporata Energjetike e Kosovës- Destrikti në Gjakovë, me kërkesë që të miratohet kërkesëpadia e paditëses si e bazuar dhe që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shumën prej 12,074,00 euro, në emër të pagave të pa paguara për punët dhe detyrat e punës si kordinator i ND në Rahovec, për periudhën prej 10.09.2010 e deri me 17.09.2012, me kamatë ligjore, duke filluar nga data e plotfuqishmëris së aktgjykimit, si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.155/12, të datës 21.11.2013, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e të ardhurave personale është plotësisht e bazuar, pasi që me provat materiale të administruara është vërtetuar fakti se paditësi tek e paditura ka themeluar marrëdhënien e punës dhe ka kryer punët dhe detyrat e punës si kordinator i ND në Rahovec, për periudhën prej 21.09.2010 e deri me 17.09.2012, dhe atë sipas kontratës së punës të nënshkruar me të paditurën, ndërsa për këtë periudhë paditëses fare nuk i janë kompensuar të ardhurat personale të cilat i kanë takuar në bazë të kontratës së punës dhe punës së kryer. Bazën juridike të kërkesëpadiës gjykata e ka vërtetuar nga aktgjykimi i plotëfuqishëm i Gjykatës Komunale në Rahovec C.nr.284/2010, datë 04.03.2011, me të cilin është anuluar si i kundërligjshëm njoftimi i të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit, si dhe është detyruar e paditura që ta kthejë paditësin në vendin e tij të punës. Në lidhje me lartësinë e të ardhurave personale të cilat i takojnë paditësit, gjykata e shkallës së parë këtë e ka vërtetuar nga tebelari mbi llogaritjen e pagave të llogaritura nga personeli i sektorit të pagave të paditurës, nr.3413, datë 21.11.2013, në të cilën është cekur shprehimisht shuma e të ardhurave të pa paguara paditësit e që është 12,074,00 euro. Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiës gjykata ju ka referuar nenit 55 pika 1 të Ligjit të Punës me nr. 03/L-212, ndërsa lidhur me shpenzimet procedurale gjykata ju ka referuar neni 452 parag.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara, nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadiës, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur e që kanë të bëjnë me mos vërtetimin e gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë. Kjo për faktin se gjykatës së shkallës së dytë i ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, pasi që nuk ka qenë kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në vendin e punës kordinator i ND në Rahovec, ndërsa poashtu nuk ka qenë kontestues fakti se paditësit për periudhën prej 10.09.2010, e deri me 17.09.2012, nuk i janë paguar të ardhurat personale në lartësinë e kërkuar. Në fakt edhe vet e paditura gjatë shqyrtimit kryesor, por edhe me ankesë e ka pranuar faktin se paditësit nuk i janë kompensuar të ardhurat personale për periudhën kontestuese.

Mbi këtë bazë gjykata e shkallës së dytë vlerëson se kundërshtimet e palës së paditur të cekura më lartë, nuk kanë fare ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike, pasi që baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar paraprakisht me aktgjykimin e plotëfuqishëm të Gjykatës Komonale në Rahovec C.nr.284/2010, datë 04.03.2011, me të cilin është anuluar si i kundërligjshëm njoftimi i të paditurës nr.1609, datë 10.09.2009 dhe vendimi nr.351, datë 29.09.2010, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit, si dhe është detyruar e paditura që ta kthejë paditësin në vendin e tij të punës. Ndërsa lartësia e të ardhurave personale që i takojnë paditësit është llogaritur nga vet e paditura përmes tebelarit mbi llogaritjen e pagave të llogaritura nga personeli i sektorit të pagave të paditurës, nr.3413 prej datës 21.11.2013. Si rrjedhojë, është detyrim ligjor i të paditurës që paditësit t'ia kompensojë të ardhurat personale për punën e kryer dhe atë në bazë të nenin 55 parag.1 të Ligjit të Punës në fuqi.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.118/14, datë 25.05.2018

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka, d.v